



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 12444 Prot

Tiranë, me 29.12. 2017

**RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR
MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË D.P.B.**

Tiranë, Dhjetor 2017

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në D.P.B., bazohet në Ligjin nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrative të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njejtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcenim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmon interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupzioni.
4. “D.P.B.” është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
5. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të Ligjit nr.60/2016.
6. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e

shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

7. “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.
8. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korruptioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik, apo subjektin privat.
9. “Sinjalizues” është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënieve së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korruptioni.
10. “Veprim ose praktikë e dyshuar korruptioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupcion.

KREU II
VEPRIMTARIA E NJËSISË PËRGJEGJËSE NË D.P.BURGJEVE

Neni 4
Parimet e veprimtarisë

1. Njësia Përgjegjëse e ngritur me Urdhërin nr.316, datë 14.12.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të D.P.Burgjeve për zbatimin e Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, bazohet në parimin e:
 - a. rruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror,
 - b. njoħjes së identitetit të sinjalizuesit, pérveç rastit kur Ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim,
 - c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupcionit,
 - d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit,
 - e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit,
 - f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

**-KREU III
VEPRIMET PROCEDURALE**

**Neni 5
Kryerja e veprimeve procedurale**

1. Veprimet procedurale të Njësisë Përgjegjëse në D.P.Burgjeve, kryhen në përputhje me Ligjin nr.60/2016, dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njësia Përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

**Neni 6
Sinjalizimi**

Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korruptionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë institucionit, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt tek Njësia Përgjegjëse brenda insitucionit, ose pranë ILDKPKI-së, sipas rastit.

**Neni 7
Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit**

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar në Njësinë Përgjegjëse, dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënrat e identitetit të sinjalizuesit,
 - b. të dhënrat e kontaktit të sinjalizuesit,
 - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korruptionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur,
 - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korruptionit,
 - e. në rastin e sinjalizimit tek ILDKPKI-ja, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

3. Sinjalizuesi mund t  zgjedh  t  mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga Nj sia P rgjegj se si i till , vet m n se n  t  jan  shprehur qart  dhe jan  arsyetuar shkaqet e animosit dhe t  dh nat e sinjalizuara sigurojn  nj  baz  t  mjaftueshme p r t  hetuar administrativisht veprimin ose praktik n e dyshuar t  korruptionit.
4. N  rastet kur sinjalizimi nuk  sht  depozituar sipas form s dhe p rmbajtjes s  m sip rme sinjalizuesit i k rkohet me shkrim t  korrigoj  k to t  meta brenda 7 dit ve nga data e marrjes s  nojftimit p r korrigim.

Neni 8 **Mbrojtja kund r hakmarrjes**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon nj  veprim ose praktik  t  dyshuar korruptioni, sipas Ligjet nr.60/2016, mbrohet ndaj  do mas  hakmarr se t  marr  ndaj t j nga organizata, duke p rfshir , por pa u kufizuar n :
 - a. shkarkimin nga puna,
 - b. pezullimin nga puna, ose t  nj , ose m  shum  detyrave,
 - c. transferimin brenda ose jasht  organizat s,
 - d. uljen n  detyr ,
 - e. uljen e pag s dhe/ose t  shp rblimeve financiare,
 - f. humbjen e statusit dhe t  privilegjeve,
 - g. mos ngritjen n  detyr ,
 - h. heqjen e s  drejt s p r t  marr  pjes  n  trajnime,
 - i. vler sime negative n  marr dh nien e pun s,
 - j. forma t  tjera t  hakmarrjes n  lidhje me pun n.
2.  do akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit  sht  i pavlefsh m.

KREU IV HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9 **Mosfillimi i hetimit administrativ**

1. Nj sia P rgjegj se ka t  drejt  t  mos filloj  hetimin administrativ n se,
 - a. sinjalizimi nuk  sht  depozituar sipas form s dhe p rmbajtjes s  k rkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigon k to t  meta brenda 7 dit ve nga data e marrjes s  nojftimit p r korrigim,

- b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij,
 - c. kur nga përbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative, ose të veprës penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të D.P.Burgjeve.

Neni 10 **Regjistrimi i sinjalizmit**

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistrer të posaçëm protokoll i elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. Njësia Përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizmit.

Neni 11 **Parimet e hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse**

1. Në kryerjen e hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse vepron :
 - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit,
 - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjeter e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave,
 - c. duke shmangur çdo konflikt interesit të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ,
 - d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre,
 - e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojë të dhënat në përbajtje të çdo sinjalizimi,
 - f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 12 **Procedura e hetimit administrativ**

1. Njësia Përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr.60/2016. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Njësia Përgjegjëse zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes, ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.
4. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe :
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione,
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit,
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njësia Përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia Përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. Njësia Përgjegjëse merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korruptionit të sinjalizuar.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit nga Njësia Përgjegjëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative sipas ligjit, Njësia Përgjegjëse sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

Neni 13 **Provat në hetimin administrativ**

1. Njësia Përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues, përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e Njësisë Përgjegjëse kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion

me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korruptionit. Dokumentimi mund të bëhet me proces-verbal, me mjete të tjera fotografike e filmike, apo në çdo mënyrë tjeter.

3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e D.P.Burgjeve vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, punonjësit bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një proces-verbal, që nënshkruhet nga zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhbllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Drejtorisë Përgjithshëm të D.P.Burgjeve.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e Njësisë Përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e Njësisë Përgjegjëse dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 13 **Përfundimi i hetimit administrativ**

1. Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse:
 - a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korruptionit është i bazuar. Në këtë rast, Njësia Përgjegjëse njofton menjëherë Prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.
2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, i arsyetur për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V
RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 14
Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përvçese me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përm bushjen e një detyrimi ligjor.
3. Njësia Përgjegjëse në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjeter, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 15
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të Ligjit nr.60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI
AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

Neni 16
Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga Njësia Përgjegjëse përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit,

përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

2. Shtyra e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

MIRATOL
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



ARBEN CUKO